



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1206 Prot.

Tiranë, më datë 04.12.2020

VENDIM  
Nr. 468, datë 04.12.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.12.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Godinë shërbimi dhe banimi 18 kate me 4 kate parkimi nëntokë”, Rr. “Medar Shtylla”, Tiranë me subjekt zhvillues shoqërinë “Nova Construction 2012” sh.p.k. dhe raporti i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor i realizuar nga person i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Godinë shërbimi dhe banimi 18 kate me 4 kate parkimi nëntokë”, si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR

Arta DOLLANI

Arta  
Dollani

Digitally signed by Arta  
Dollani  
DN: cn=Arta, o=Instituti i  
Monumenteve te Kultures,  
title=Drejtori i  
Pergjithshem, cn=Arta  
Dollani  
Date: 2020.12.04 12:09:40  
+01'00'

Elva  
Margariti

Digitally signed  
by Elva Margariti  
Date: 2020.12.04  
13:17:22 +01'00'